



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
29.05.2025

Me datë 29.05.2025, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Edmond Ndou, Jona Leqejza, Bledianë Nika, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkocaj, Armela Brahimi, Mirsad Bashi, Ardit Taflaj, Hedije Nasa, Gëzim Galiqi, Alma Mehmetaj, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Izmira Rusi, Artan Haxhi, Irma Kopliku, Valjeta Bajraktari, Eliona Shkrela, Elis Doçi, Elmira Ndervashaj, Ardit Behri, Gjenarin Kapcari, Aleksander Pashuku, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Ervin Brahimi, Ardita Spahija, Samed Bushati, Suada Kopshti, Vjoleta Përndrecaj, Fatmir Vojvoda, Blendi Gjylbegaj, Imeldi Sokoli, Muharrem Shkjau, Amila Lici, Jetmira Rraboshta.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. *Projektvendim: “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit tip ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe distributorëve vendas dhe të huaj për shfaqjen e prodhimeve audiovizuale në Kinema “Republika”.*
2. *Projektvendim: “Për miratimin e kërkesës për transferim në pronësi, të pasurisë me Nr.2/170, Vol 9, faqe 140, ZK 8591 nga Ministria e Financave tek Bashkia Shkodër”.*
3. *Projektvendim : “ Për dhënie pëlqimi, shtesa dhe ndryshime për shoqërinë aksionare “Bio Strajca”, në pronësi të Bashkisë Shkodër”*
4. *Projektvendim: “Për dhënien e të drejtës dhe caktimin e përgjegjësisë së menaxhimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së plazheve publike të menaxhueshme për shoqërinë aksionere në pronësi të Bashkisë Shkodër me nipt M369240030”.*
5. *Projektvendim: “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm*

përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar dhe detajim të fondeve sipas aktit normativ Nr.5 datë 19.12.2024 të Ministrisë së Financave”.

6. *Projektvendim: “Për miratimin e planit “Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në Bashkinë Shkodër për vitin 2025”.*
7. *Projektvendim: “Për miratimin e “Planit të përbashkët të menaxhimit të rrezikut nga zjarri” në kuadër të projektit “ Bulding Smart Forests” .*
8. *Projektvendim: “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar”.*
9. *Projektvendim: “Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2026-2028”.*
10. *Projektvendim: “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Shkodër”.*
11. *Projektvendim: “Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Shkodër”.*
12. *Projektvendim: “ Për miratimin e memorandumit të bashkëpunimit mbështetje për zhvillim 2023-2024 projekti “Bashki të forta”- Bashkia Shkodër”*
13. *Pr/Vendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Prill 2025”.*
14. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Kourumi i domosdoshëm është prezent në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

Para se të hidhet në votim rendi i ditës **Z.Bjanku** merr fjalën dhe shprehet se edhe herën e kaluar kemi diskutu dhe theksuam, që është e rëndësishme që të kalojnë si pikë të para disa vendimmarrje, të cilat gjejnë konsensusin e të gjithëve.

Pra, ato pika që nuk kanë diskutime dhe janë të prekshme për qytetarët, siç është ndihma ekonomike, prandaj unë propozoj që ndihma ekonomike të kalojë si pikë e parë e rendit të ditës, dhe të vazhdojmë më pas me të gjitha pikat e tjera sipas rendit të vendosur.

Z.Luli kërkon mendimin e kryetarëve të grupeve. Z.Ndou shprehet se përsa i përket propozimit të zotit Bianku, mendon se duhet ta hedhim në votim, pasi edhe dy herë të tjera nuk është kaluar si projekt vendim.

Z. Sokoli po ashtu shprehet se edhe grupi i PSD-së është pro që ky projekt vendim të kalojë si pikë e parë e rendi i ditës.

Hidhet në votim rendi i ditës me propozimin e Z.Bjanku , ku rezultojnë **40** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Z.Bjanku përsëri për procedurë shprehet që duhet patur parasysh që të tilla çështje sensitive t'i lemë si pika të para të rendin e ditës e më pas të kalojmë në shqyrtimin e pikave të tjera.

Kalohet në votimin e pr.vendimit: *“Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Prill 2025”*, ku rezultojnë **40** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e rradhës së rendit të ditës: *“Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit tip ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe distributorëve vendas dhe të huaj për shfaqjen e prodhimeve audiovizuale në Kinema “Republika”*.

Relaton për këtë pikë **Znj.Smaja**, drejtoreshë kulture në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Bjanku shprehet se grupi BF-së parimisht është dakort me pjesën , që kinemaja e qytetit ka nevojë përveç rikonstruksionit të fitojë edhe funksionin, qëllimin primar që ka ajo, që është transmetimi i filmave. Por do donim të dinim më shumë te aspekti ekonomik, pra menaxhimi i të ardhurave ,sa do të paguhen, distributori, sa do të përfitojë kinemaja, Bashkia, ku do të shkojnë të ardhura dhe pse pikërisht është vendos ai raport, që keni vendosur në relacion.

Përgjigjet **Znj. Smaja** duke thënë se për gjithë rajonin pra Kosovë, Shqipëri, Mal i Zi, Maqedoni, janë disa distributorë të cilët kanë të drejtat e transmetimit të filmave. Këta janë distributorë të mëdhenj që zakonisht bëjnë marreveshje me Paramount-in, me Disney, kushdo që ka prodhuar filmin. Dhe këta distributorë e kanë si kusht të vetin dhe kjo marrëveshje është e konsultuar, po themi, me distributorët që e ofrojnë këtë shërbim dhe është gjysma e vlerës që ne kemi në paketë fiskale. Gjysmën e merr Bashkia në këtë rast dhe gjysmën distributori. Kjo është praktika, është propozimi i tyre, këto janë kushtet e marrëveshjes për të marr filmat me distributorët ekskluzivë.

Z. I.Sokoli shprehet se duhet të jeni të kujdesshëm me terminologjinë që përdorni, sepse kinemaja është duke u rikonstruktuar dhe kjo nuk ka leje ndërtimi. Kështu që mos e mos e përfshini si të tillë, sepse në qoftë se ajo është duke u rikonstruktuar, ajo ka nevojë për leje ndërtimi të lëshuar nga institucionet përkatëse sepse ajo është edhe monument kulture dhe në momentin që ajo nuk ka leje ndërtimit për këtë punë, IMT-ja e Bashkisë duhet të ndërhyjë dhe ta klasifikojë si ndërtim pa leje.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku Z.Ndou shprehen Pro, po ashtu edhe Z.Sokoli shprehet pro dhe shton se në vazhdimësi do jetë Znj.Pode që do flasë në emër të grupit të PSD-së. Në emër të grupit Bashkë Fitojmë.Z.Bjanku thotë se e vetmja rezervë që kishim ishte ky aspekt financiar faktikisht edhe po besojmë pjesën që këto janë vlerat të standardizuara dhe kështu që votojmë Pro.

Hidhet në votim Pr/vendimi: : “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit tip ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe distributorëve vendas dhe të huaj për shfaqjen e prodhimeve audiovizuale në Kinema “Republika”, ku rezultojnë **41** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën tjetër të rendit të ditës: *Projektvendim: “Për miratimin e kërkesës për transferim në pronësi, të pasurisë me Nr.2/170, Vol 9, faqe140, ZK 8591 nga Ministria e Financave tek Bashkia Shkodër”*.

Relaton për këtë pikë **Zv/Kryetari i Bashkisë, Z.Preka**, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku Z.Ndou dhe Znj.Pode shprehet dakort pr/vendimit. Z.Bjanku thotë se do ishte mirë që të përcaktohet që në fillim destinacioni se për ku do përdoren këto objekte. Megjithatë shprehin dakordësi.

Hidhet në votim Pr/vendimi: *Projektvendim: “Për miratimin e kërkesës për transferim në pronësi, të pasurisë me Nr.2/170, Vol 9, faqe140, ZK 8591 nga Ministria e Financave tek Bashkia Shkodër”* ku rezultojnë **41** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika e rradhës: *Projektvendim : “ Për dhënie pëlqimi, shtesa dhe ndryshime për shoqërinë aksionare “Bio Strajca”, në pronësi të Bashkisë Shkodër”*

Relaton për këtë pikë **Z.Renato Lumçi**, drejtor i drejtorisë së Turizmit, në Bashkinë Shkodër.

Fjalën e merr **Znj.Bajraktari**, e cila thotë se sot po kërkohet një shtim i gamës së shërbimeve të “Bio Strajcës”. Në qoftë se deri më sot ajo kishte menaxhimin dhe administrimin e tregjeve bujqësore dhe blektorale, do të shtohet menaxhimi i plazheve, shërbime për produkte turistike, aktivitetet e operatorit turistik të turizmit detar, agjentë për qiramarrje dhe tregtinë, organizim shfaqesh, koncertesh.

Bashkia e Shkodrës para një viti e gjysëm bëri një organizim për një mirë funksionim. U miratua Ndërmarrja e shërbimeve, e cila mbulon plazhet. Kemi Drejtorinë e Turizmit që mbulon turizmin, produkte turistike, turizmin detar, Drejtoria e Kulturës dhe Sportit. Dhe mbi këto ne po kërkojmë t'i japim, ta fuqizojmë “Bio Strajcën”. Faktikisht , megjithëse ka kaluar një vit e gjysmë nga miratimi i kësaj sh.a-je, nuk është se kemi informacione, megjithëse ka qënë Këshilli Bashkiak që e ka miratuar.

Nuk kemi asnjë informacion se si organizohet, si është e ndërtuar ajo. Nëse do shohim informacion nga interneti, vërejmë që kemi një administrator që është Halit Bilali dhe tre anëtar të Këshillit Administrativ, që janë Ermira Teliti, Kozeta Jane dhe Halit Bilali.

Tek akti i themelimit të shoqërisë, thuhet që aty ka edhe një asamble të përgjithshme. Përsëri nuk ka informacion për këtë. Kemi edhe një drejtor teknik. Pra, informacionet për këtë sh.a, të cilën ne po e fuqizojmë kaq shumë, aq sa po e kalojmë pak a shumë edhe mbi Bashkinë, janë krejt pakta. Dhe në qoftë se ne do t'i japim gjithë këto funksione, sa do të jetë numri i punonjësve që do të ketë kjo sh.a për me kryer gjithë këto? Dhe ç'lidhje do të ketë me drejtoritë e Bashkisë?

Z. Elvin Brahimi, drejtor i “Bio Strajca” sh.a , përgjigjet duke sqaruar në mënyrë të detajuar mbi strukturën, punonjësit e saj dhe lidhjen që kjo shoqëri me drejtoritë e cituara të Bashkisë Shkodër.

Përsëri **Znj.Bajraktari** pyet meqënëse s'kemi informacion, ndërmarrja a është me humbje apo me fitim?

Përgjigjet **Z.Brahimi** duke thënë se viti i parë fiskal duhet konsiderohet si një start up dhe është mbyllur me humbje. Kjo është edhe një prej arsyeve për ta bërë më rentabël. Synojmë të rrisim gamën e aktiviteteve të cilat performohen nga kjo ndërmarrje.

Z. I.Sokoli: pra ne nuk kemi informacion dhe nuk kemi një dokument justifikues që tregon që administrimi i këtyre shërbimeve të reja do bëhet më mirë dhe i matur me indikatorë, që do të thotë që për shembull, administrimi i tregjeve me indikator të faktuar është më mirë sesa kur është i zhvilluar nga Bashkia. Sepse gjëra të tilla japin fakte që ju realisht po punoni për përmirësimin e shërbimeve që ju po merrni përsipër. Aq më tepër që ju thoni, vetë që kemi dal me humbje.Ndërkohë doni të shtoni shërbime të tjera shtesë dhe nuk jepni një justifikim, një plan biznesi për të dhënë mundësinë, se si duhet të rrisni performansat e këtyre shërbimeve dhe patjetër edhe në terma ekonomik. Në këtë mënyrë, ky vendim bëhet i pamatshëm dhe kalon në terma shumë arbitrare. A keni një përgjigje për këtë pjesë të planit të biznesit?

Një plan biznesi për të dhënë mundësinë, pra, se si duhet të rrisni performansat e këtyre shërbimeve dhe patjetër edhe në terma në terma ekonomik. Në këtë mënyrë, kjo, ky vendim bëhet i pamatshëm dhe kalon në terma shumë arbitrarë.

Përsëri përgjigjet **Z.Brahimi** duke thënë se në qoftë se flasim për shifra, në lidhje me merkaten e Rusit, më përpara kanë qenë rreth 56 kontrata të lidhura, sot janë mbi 80. Në qoftë se flasim në terma të efikasitetit, aspekti tjetër ka të bëjë edhe me organizimin e aktiviteteve që lidhen me artizanatin ose me edhe me prodhues të tjerë lokal, të cilët mund të them pa frikë që janë 10 më shumë se vitin e kaluar nga kjo ndërmarrje.

Nga ana tjetër, në funksion të zhvillimit të turizmit dhe rritjes së ofertë turistike, patjetër që tek të ardhurat e kësaj ndërmarrjeje, zë jo pak i rëndësishëm është edhe ai i të ardhurave që sigurohen nga aktivitetet me varkat e turizmit, të cilat ndodhen në Shirokë.

Në aspektin e dytë, që ka të bëjë me një plan biznesi, patjetër që logjika edhe ushtrimi bëhet me një plan të mirëfilltë biznesi, duke marrë parasysh kostot e investimit, të cilat janë paraqitur në relacion, po nga ana tjetër edhe kthimin e këtij investimi.

Ai shton se megjithëse po flasim për fonde publike, nga ana tjetër, rentabiliteti, kthimi nga investimi edhe gjithë parimet e tjera duhet të aplikohen. Dhe po është një plan i mirëfilltë biznesi. Nisur nga ky plan, ne kemi propozuar edhe një tarifë të rishikuar më të ulët sepse duke mos qenë, objektivi primar maksimizimi i fitimit, kemi hapësirë që të kemi shfrytëzim eficient edhe rentabël të këtyre aseteve me një çmim më të ulët për qytetarët. Patjetër që mund t'iu vihet në dispozicion plani i mirëfilltë i biznesit.

Z.I.Sokoli vijon duke thënë se për më tepër keni një logo që në fakt është e dublikuar. Ajo është logoja e Muzeumit të Qytetit të Shkodrës, që është e dublikuar. Duhet minimalisht që mos të dublikoni logo, po thjesht të ketë dy logo që të dallohet qartë se e kujt është, e muzeumit apo kësaj sh.a-je ?

Z.Luli pyet nëse logoja e muzeumit është e regjistruar? Është e rëndësishme që logoja të jetë e regjistruar për të folur pastaj për dublime.

Edhe **Z.Brahimi** sqaron se përsa i përket emrit, ajo që ne synojmë të arrijmë nëpërmjet kësaj ndërmarrje ka të bëjë edhe me identitetin patjetër, ka të bëjë edhe me zhvillimin ekonomik, edhe me etimologjinë. Dhe në qoftë se nuk do të ishte diçka, unike as njëherë s'do ta kishim zgjedhur.

Për më tepër nëse do kishte problem regjistrimi i markës apo të logos, që nuk besoj që jemi këto kushte, patjetër që kërkesa juaj duhet marrë në konsideratë.

Kurse në lidhje me termin, plazhe private dhe publike..., nëse referohemi edhe VKM-së, cilësohen si plazhe publike, ata të cilët bashkia i mirëmban edhe janë pa pagesë edhe plazhet e menaxhuara. Plazhet e menaxhuara nëndahen në dy kategori, ato që menaxhohen nga pjesa e hotelerisë, kontratat të lidhura apo në proces edhe pjesa tjetër që administrohen nga Bashkia.

Për më tepër sqaron këtu **Zv.Kryetari Preka**, duke thënë se materiali i paraqitur ka informacione të mjaftueshme për sa po kërkohet. Sot jemi për të diskutuar një ndryshim në emrin për sa i përket projekt vendimit, i cili vjen faktikisht për faktin që po i shtohen kompetencat Bio Strajcës. Duhet të keni parasysh, që këto kompetenca nuk i shtohen në dëm të qytetarëve, po thjesht po bashkohen kompetencat e një shoqërie tregtare të krijuar, që ka një staf që e menaxhon dhe ul kostot përkundër krijimit të një shoqërie tjetër tregtare. Pra i vetmi organ që do i menaxhojë plazhet është bashkia dhe hoteleria sipas VKM-së. E thënë ndryshe ato sipërfaqe publike, që ndër vite trajtohen në mënyrë jo të dinjitoze dhe realisht rëndojnë në buxhetin e çdo qytetari të Shkodrës dhe çdo pushuesit, do t'i menaxhojë Bashkia.

Z.Sokoli shprehet se nuk mund të themi jo dinjitoze. Kjo është detyrim...

Zv.Kryetari Preka, vijon duke thënë se patjetër që ky është një projekt ambicioz. Do kërkojë kohën e vet dhe jo gjithë sipërfaqja aktualisht me atë që propozojmë ne do të trajtohet nga Sh.a-ja.

Pjesa tjetër e sipërfaqes do të jetë publike pa pagesë, por edhe tek ajo që pretendoni që është e menaxhuar, patjetër do të jenë shumë më ekonomike dhe do kursejë partë e qytetarëve shkodranë dhe atyre që vijnë për të bërë turizëm në qytetin e Shkodrës dhe bregdetin e Velipojës me çmime shumë më të lira dhe më të mira.

Z.I.Sokoli në replikë të asaj që u tha edhe njëherë këtu në çdo vendim është procedurë që ju të justifikoni vendimin që bini në Këshillin Bashkiak. Po të vërtetë nuk ka organigram. Ne nuk e dimë ligjërisht, se cila është organigrama e Bio Strajcës ose e Shkodrinonit, quajeni si të doni. Nuk ka një plan biznesi të sjellë në dorën e këshilltarëve. Dhe ju nuk keni asnjë fakt si ta mbronë këtë. E dyta, administrimi dhe menaxhimi i hapësirave të plazheve ka qenë detyrim edhe me VKM-në e vjetër edhe me VKM-në e re. Pra nuk është gjë e shtuar dhe ne kemi precedentin e vitit që kaloi. Kem miratuar skemën e plazheve këtu me kushte, që ju të përmirësoni aksesin drejt plazheve publike dhe nuk e keni bërë, të përmirësoni aksesin e njerëzve me aftësi ndryshe në plazhe dhe as kjo nuk është bërë. Dhe tani ju thoni që duam të marrim dhe 40 milionë lekë të tjera në mënyrë që të përmirësojmë administrimin e plazheve. Kjo është vetëm kosto e shtuar për xhepat e qytetarëve.

Bashkia nuk duhet të bëjë biznes por të rrisë performancën e ofrimit të shërbimeve publike në territorin e saj.

Përsëri **Z.Preka** thotë se sh.a-ja patjetër që do të justifikojë veten, shpenzimet dhe do të ofrojë shërbimin. Dhe si mund të themi që kjo rëndon tek qytetarët? Nëse një shëzlon në Velipojë është dhënë me 10.000 lekë dhe Sh.a-ja ta ofrojë me 3.000 lekë? Kjo nuk do jetë taksë e dyfishtë, përkundrazi ne po mundohemi të ndalojmë abuzimet.

Znj.Osja kërkon të dijë se cilës VKM iu rreferua kolegu, pasi VKM-ja e re sjell mjaft risi në përmirësimin e shërbime.

Fjalën e merr **Znj.Leqejza**, e cila shprehet se dëshiron të jetë konsistente me të gjitha qëndrimet që ka mbajtur ndër vite. Këshilli Bashkiak nuk është noter apo gardian i ligjit dhe i akteve ligjore. Thënë kjo, do të citoj vetëm një pikë të ligjit 139 neni 9 që e bën Këshillin Bashkiak pronar të të gjitha pronave të Bashkisë Shkodër përfshirë edhe plazhet. Dhe pa dashur të hyjë këtu në detaje tjera teknike, si pronë e Bashkisë Shkodër në këtë rast është edhe plazhi dhe kjo na jep të drejtën me vendos për mynyrën e menaxhimit të tij. Gjithashtu ligji 139 I jep të drejtën edhe ekzekutivit me propozuar një formulë menaxhimi dhe në këtë rast më lejoni të përgëzoj drejtorin për prezantimin shumë të mirë që i bëni formulës së re të menaxhimit që propozojnë. Nëpërmjet një menaxhimi të integruar, nëpërmjet një shoqërie tregtare me mundësi vetëfinancimit mund të arrihet dhe një shërbim më i mirë.

Për më tepër shton ajo, duke qenë se kam kritika personale për VKM-në e famshme që i jep të tretëve të drejtën e menaxhimit të plazheve pa i vënë kushte, unë e shoh këto si një nisje të shkëlqyer nga ana menaxheriale por dhe vizionare që të themi se ne po i ofrojmë publikut me një tarifë të përballueshme një shërbim të mirë. Prandaj ajo fton kolegët ta votojnë këtë pr/vendim.

Znj. Shkrela merr fjalën dhe thotë se po flasim sot për t'i besuar një shoqërie aksionere , e cila që në vitin e parë të ekzistencës së saj ka dal me humbje. Dhe është e palogjikshme në fakt të flitet këtu për sukses. Për më tepër shton ajo, jam dakord me kolegët që Bashkia Shkodër ka disa drejtori, ka drejtorinë e Shërbimeve, Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, drejtorinë e Kulturës, të turizmit dhe nuk ka nevojë për këtë sh.a.

Këtu u tha nga Nën Kryetari që shoqëria aksionere ka 11 punonjës dhe këta punonjës a mund të jenë mjaftueshëm për të ofruar një shërbim ma të mirë?

Në këtë mënyrë i hiqet kompetenca edhe njësive administrative që në fakt dinë më shumë për menaxhimin e plazhevesi p.sh NJ.A e Velipojës. Prandaj më parë duhet të kemi një plan të mirëmenduar që të mund ti besojmë të tjera kompetenca dhe shërbime kësaj sh.a-je.

Për më tepër u fol për aktivitete që në fakt këto nuk i kanë munguar asnjëherë Shkodrës. Këtu çdo vit janë organizuar panairë bujqësore, panairë me produkte të ndryshme artizanale dhe kjo shoqëri nuk ka sjell asnjë risi që nuk e kemi pa. Vlen kjo edhe për Tregun e Rusit, që nuk mendoj se është arritur ndonjë gjë shumë e madhe.

Edhe **Z.Galiqi** thotë se ai e sheh këtë Shoqëri për të përmirësuar cilësinë e shërbimit, jo detyrimisht të hapë një profil të caktuar. Prandaj edhe për këtë arsye nuk mendon se ka ndonjë sens të madh

ndërtimi i një plan biznesi për një shoqni aksionere bijë e Vllaznisë, për të cilën ajo do të krijojë një muri funksionesh dhe në një lloj mënyrë unë aprovoj këtë fakt për diçka esencial.

Ne do e shohim performancën e kësaj shoqnie, në fillim të shtatorit duke qenë se gjithë jemi njerëz që e frekuentojmë plazhin e Velipojës, Ky është një lloj, po e quajmë eksperimentit, që bën Bashkia për të marr përgjegjësi më shumë për cilësinë e shërbimit në plazhe. Ai shton se duhet t'ia japim këtë mundësi.

Znj.Pode, shprehet se duke referuar dhe shoqërive të tjera aksionere që operojnë në vendin tonë, nga eksperiencia të ndryshme, vërehet se viti i parë dhe viti i dytë i këtyre shoqërive kanë kaluar një lloj vështirësie të për t'arritur dhe për tu konsoliduar. Prandaj duhet të kemi një shpresë dhe një dritë jeshile për mënyrën e re në të cilën po operohet për menaxhimin sa më të suksesshëm plazheve që operojnë në Bashkinë Shkodër, siç është plazhi i Velipojës. Këte e shikojmë pozitivisht që tek çmimi, i cili është vendos si diçka simbolike dhe diçka e menaxhueshme edhe nga vetë qytetarët e Shkodrës, duke iu ofruar edhe kushte pastërtie etj. Vetëm diçka që ngelet për përmirësim është, siç tha **Znj Liqejza**, edhe përmësimi i infrastrukturës për personat me aftësi ndryshe.

Z.Bjanku, po flitet për një çmim simbolik... A është vendosur në të vërtetë ky çmim?

Përgjigjet **Z.Brahimi** duke sqaruar se çmimi është pjesë e analizës financiare që është bërë dhe nuk ka një çmim të miratuar. Megjithatë, është bërë një llogaritje diku tek 350-400 lekë të reja, por nuk ka një çmim të miratuar.

Përsëri **Z.Bjanku** thotë se kjo përkthehet përsëri si tarifim i dyfishtë për qytetarët. Nuk mund të jepet me pagesë plazhi publik. Bashkia Shkodër ka detyrim të mirëmbajtje dhe menaxhojë kto plazhe dhe jo t,ia kalojmë një sh.a-je.

Z. Gjylbegaj shprehet se sot po diskutohen dy projekt vendime njëherësh duke qënë se kanë lidhje me njëri tjetrin. Ne kërkojmë të dijmë sa është tarifa e vendosur që ta gjykojmë dhe të mos mbetet totalisht në dorë të sh.a-së dhe të lihet vend për abuzime. U kuptua që sh.a-ja do t'ë blejë shazëllonat, çadra, të shtojë organigramin, ta mirëmbajtë, ta pastrojë, ta rregullojë dhe të funksionojë si një Sh.a. Unë do e miratoja në qoftë se ju më thoni një tarifë të arsyshme për publikun dhe e mirëpres që të ketë qytetarë që shkojnë, vendosin cadrat edhe te hapësirat publike pa lek, por edhe tek ato hapësira që menaxhon Bshkia sepse e di që ato lekë do shkojnë prapë në arkën e Bashkisë dhe rikthehen në një investim në një formë tjetër.

Z.Shkjau thotë se të gjithë e dimë që Velipoja është një asset, por si është menduar për bizneset që kanë operuar deri tani aty. A është diskutuar me to?

Përgjigjet **Z.Brahimi**, se sot kemi ardhur për të miratuar këtë pr/vendim i cili do të ketë nevojë për punojës, që patjetër do të shtohen kryesisht nga zona e Velipojës. Pra që do ketë efekte edhe në punësim edhe një prej aktorëve, pse jo, që duhet marr në konsideratë edhe për eksperiencën e tyre duhet të jenë edhe aktorë që më përpara kanë ushtruar këtë aktivitet.

Znj.Mehmetaj merr fjalën dhe thotë se dëshiron vetëm të bëjë një ndërhyrje më shumë edhe për publikun, por me disa terma dhe nocione që po përdoren nga koleget.

Kur themi taksim i dyfishë për një qytetar, ka të bëjë kur kemi të njëjten të ardhur dhe ti taksosh për atë të ardhur në dy vende apo në dy shtete të ndryshme, që në rastin e projekt vendimit që po diskutojmë nuk ka të bëjë fare dhe do doja që të mos përdoren terma që në një farë mënyre nga publiku ose mund të keqkuptohen ose nuk janë të sakta.

Ajo çfarë duhet të sigurojë Sh.a-ja është që gjithmonë ky çmim, ashtu siç edhe u referua, është më poshtë se çmimi që jep sot privati. Pra, ne si këshilltarë dhe si qytetar duhet të marrim këtë siguri.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve.Z.Ndou vlereson pr/vendimin dhe vizionin dhe shprehet dakort. Po ashtu edhe Znj.Pode shprehet pro. Kurse Z.Bjanku shprehet se duke mos parë akoma punën e mirë të kësaj Shoqërie dhe duke qënë se kemi një shpërndarje të panevojshme shërbimej jemi kundër.

Hidhet në votim Pr/vendimi: “ *Për dhënie pëlqimi, shtesa dhe ndryshime për shoqërinë aksionare “Bio Strajca”, në pronësi të Bashkisë Shkodër*”, ku rezultojnë **28** vota Pro **14** Kundër **0** Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pr/vendimin: “*Për dhënien e të drejtës dhe caktimin e përgjegjësisë së menaxhimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së plazheve publike të menaxhueshme për shoqërinë aksionare në pronësi të Bashkisë Shkodër me nipt M369240030*”.

Znj.Pode thotë se kjo pikë nuk ka nevojë për diskutime të tjera meqënëse u diskutua mjaftueshëm.

Z.Luli thotë se është pjesë e procedurës....dhe kërkohet të hidhen në voting të gjitha pikat ndarazi.

Z.Behri kërkon të dijë se për sa vite do t'i menaxhojë Bashkia këto plazhe, duke qënë se viti i parë i kësaj shoqërie ka qënë me humbje? Dhe a është menduar të ketë vrojtues të licensuar në këto plazhe?

Përgjigjet **Z.Lumçi** duke sqaruar se plazhet do menaxhohen sipas dispozitave të vendimit të Këshillit të Ministrave.Dhe përsa i përket numrit të plazheve, janë caktuar dhjetë plazhe. Për momentin nuk është caktuar vendi ekzakt ku do të jenë. Menaxhimi do jetë për 5 Vite.

Z. Sokoli kërkon të dijë për pjesën e detajimit të shifrës 40 milionë. Ne këtu, në 3 vendime edhe në vendimin parardhës të tij që po miratojmë, na thuhet që do bëhen blerje 2000 shezlonge dhe 1000 çadra. E para si e prioritarizoni ju këtë nevojë në raport me nevojat e tjera të Bashkisë. Për të shtruar një rrugë, për te përmirësuar një shkollë, etj?

Dhe pika tjetër ka të bëjnë përsëri me plazhet, se si do e mirëadministroni ju plazhin duke justifikuar në VKB që keni bërë vetëm blerjen e çadrave dhe shezlongeve.

Përsëri **Z.Brahimi** përgjigjet se kjo nuk përfshin vetëm set çadra dhe shezlong, ka kufizuese, dhomat e zhveshjeve, tualetet, pasarelet e drurit, tabelat e treguesve të plazheve dhe deri tek seti i karrigeve dhe çader për ojëtruesin e plazhit.Cdo gjë është e llogaritur për sa është e nevojshme.

Kalohet tek mendimi i kryetarit të grupeve Z.Ndou dhe shprehet dakort pr/aktit. Po ashtu edhe Znj.Pode shprehet pro. Kurse Z.Bjanku thotë se duke qëndruar në të njëjtën linjë, se qytetarët po taksohen dyfish shprehen kundër.

Hidhet në votim Pr/vendimi: “Për dhënien e të drejtës dhe caktimin e përgjegjësisë së menaxhimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së plazheve publike të menaxhueshme për shoqërinë aksionere në pronësi të Bashkisë Shkodër me nipt M36924003O”. ku rezultojnë **28** vota Pro **13** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pr/vendimin: “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar dhe detajim të fondeve sipas aktit normativ Nr.5 datë 19.12.2024 të Ministrisë së Financave”.

Pyetje e diskutime nuk ka.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve Z.Ndou shprehet dakort pr/aktit. Po ashtu edhe Znj.Pode shprehet pro. Kurse Z.Bjanku thotë se bëhet fjalë për 40 milion dhe kjo rendon në xhepat e qytetareve, prandaj shprehemi kundër.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **28** vota Pro **10** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pr/vendimin : “Për miratimin e planit “Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në Bashkinë Shkodër për vitin 2025”.

Relaton për këtë pr/akt **Z.Ndoci**, specialist pranë drejtorisë së Mjedisit në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Bjanku kërkon të dijë nëse ka risi ose ndryshime në krahasim me planin e vitit të kaluar?

Përgjigjet **Z.Ndoci**, i cili sqaron se ky plan nuk ka risi, por përditësohet vit pas viti nga ana teknike por jo në funksione.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehen dakort pr/vendimit.

Pr/vendimi hidhet në votim, ku rezultojnë **28** vota Pro **10** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika tjetër e rendit të ditës: *Projektvendim: “Për miratimin e “Planit të përbashkët të menaxhimit të rrezikut nga zjarri” në kuadër të projektit “ Bulding Smart Forests”*.

Përsëri relaton për këtë pr/akt **Z.Ndoci**, specialist pranë drejtorisë së Mjedisit në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Sokoli ka një diskutim në këtë pikë, ai shprehet se përse i përket dy vendimeve, po ti marrim veç e veç pra, shohim që njëra vjen si, kushtëzim ligjor që e ka kompetencë bashkia, tjetra vjen si kushtëzim i projektit IPA. Por po ta shikojmë nga ana teknike, ka mbivendosje të dy planeve. Në këtë rast shumë kollaj mund të ishte miratuar vetëm plani i financuar nga IPA dhe mund të mbështeste edhe planin që ju sapo na prezantuat. Por, kjo është diskutim që është teknik i Drejtorisë së Menaxhimit të Mjedisit. Ajo që duhet të tërheqë vëmendjen është që, ne nuk kena bërë asnjë hap përse i përket setit të dokumenteve të reduktimit të riskut në kuadër të ligjit të reduktimit të riskut për përse i përket zonës së mbrojtjes civile.

Këto dokumenta janë dokumenta sektoriale të, reduktimit të riskut dhe nuk kemi një dokument gjithëpërfshirës për gjithë rrisqet, sepse Bashkia Shkodër në kuadër të planit të reduktimit, planit kombëtar të reduktimit të riskut është bashkia që ka riskun më të lartë në Shqipëri.

Z.Ndoci pergjigjet që plani për masat e parandalimit të shkuarjes së zjarreve në fondin pyjor për Bashkinë Shkodër përfshin gjithë sipërfaqen e Bashkisë Shkodër ndërsa plani I përbashkët për menaxhimin e rrezikut është plan që ka lidhje me Cross Border- in dhe nuk mund të mbivendosen sepse në rastin e këtij të dytë janë edhe zonat e mbrojtura etj.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve; **Z.Ndou** dhe **Znj.Pode** shprehin dakordësi, kurse **Z.Bjanku** thotë se në parim jemi pro, por në këtë rast duhet një vemendje tjetër për Zjarrfiksen, sepse ato vuajnë për gjëra elementare dhe mbështjen e gjejnë vetëm përmes marrëveshjeve të vendeve tjera edhe kjo nuk është as shumë dinjitoze.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **34** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet në pikën e radhës: *Projektvendim: “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar”.*

Relaton për këtë pr/vendim **Z.Dani**, drejtor i Emergjencave Civile, sipas materialit të përgatitur nga administrata e Bashkisë.

Z.Sokoli pyet se çfarë investimesh ose çfarë rehabilitim rrugësh do të bëjmë ne për pastrim nga bora?

Përgjigjet këtu **z.Dani**, i cili thotë se ky fond nuk parashikon vetëm rreshjet e borës, por edhe mirëmbajtjen e rrugëve nga rreshjet e shiut, bllokimet e rrugëve dhe një sërë problematikash kryesisht për zonat rurale.

Z.Bjanku pyet se a është menduar diçka për disa objekte ndërtimore që kanë vlera shumë të rëndësishme historike, por që janë të rrezikshme dhe të cilat mund të krijojnë pasoja shumë të ndjeshme, por që rrezikojnë edhe jetën e njerëzve. A ka ndonjë lloj vlerësimi apo ndonjë lloj ndërhyrjeje?

Përgjigjet **Z.Dani** duke thënë se ne i kemi adresuar tek Instituti i Ndërtimit. Ne kemi përgatitur relacionin tonë si Drejtori Emergjencash Civile dhe i kemi vendosur në hapat e duhur, në të cilat duhet të kalojnë normalisht.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve; **Z.Ndou** dhe **Znj.Pode** shprehin dakordësi, po ashtu edhe **Z.Bjanku** shprehet dakort pr/vendimit.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **32** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën tjetër të rëndësishme të ditës: : *“Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2026-2028”.*

Relaton për këtë pr/akt **Znj.Elma Piraniqi**, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj.Bajraktari, shprehet se në qoftë se shohim të ardhurat nga burimet e veta pritshmërinë për 2028 janë në ulje. Pse është kjo ulje, për vitet të pasardhëse?

Përgjigjet **Znj.Piraniqi** duke thënë se kjo ulje vjen si rezultat i tarifave pasi ne kemi edhe tarifen e dhënies së licencës së karburanteve, e të cilat kanë një periudhë pesëvjeçare dhe përlllogaritja e tyre bëhet duke u bazuar tek afati i përfundimit të licencave dhe prandaj vjen me zbritje. Kurse përsa i përket tarifës së pastrimit bëhet fjalë për një debi e cila do të kalohet për vitet e ardhshme për arkëtim.

Z.Sokoli shprehet se këto dy vendime dhe vendimi i pasardhës në kuadër të miratimit të buxhetit vitit 2026. Detyrimi ligjor është që të miratohen deri me 31.01.2025. Pra ju miratoni një plan buxheti, ndërkohë që e kemi miratuar në mbledhjen e fundit të vitit kaluar, ndërkohë nuk e zbatojmë, sepse vendimet vijnë tre muaj me vonesë.

Z.Bjanku pyet se duke qënë se do kemi shtesë të ardhurash nga veprimtaria e Sh.a-së Bio Strajca, konkretisht çfarë të ardhurash janë menduar ose çfarë të ardhurash do të krijojë kjo shoqëri nga gjithë veprimtaria ekonomike që po realizon?

Përgjigjet **Znj.Piraniqi** dhe se duke patur parasysh që është një Sh.a dhe ajo ashtu siç ka shpenzimet dhe të ardhurat e veta, do t'i menaxhojë vetë ato ndërsa këto janë tarifa dhe taksat e miratuara në paketë fiskale nëpërmjet vendimit të Këshillit dhe këtu nuk janë të përfshira sa i përket parashikimit afatmesëm.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve; Z.Ndou dhe Znj.Pode shprehin dakordësi, kurse Z.Bjanku shprehet se nuk është dakord pr/vendimit, pasi kanë një qasje tjetër për këtë. aq më tepër që ato kanë votuar kundër edhe paketën fiskale, pasi mendojnë se nuk ka një besueshmeri.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **25** vota Pro **9** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika e radhës: *“Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2026-2028”*.

Relaton për këtë pr/akt **Znj.Teuta Haxhi**, drejtoreshë e përgjithshme e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Bjanku ndërhyr duke thënë se baza ligjore është e njëjtë prandaj mira do ishte të flisnim për risitë dhe ndryshimet që do sjell ky vendim.

Znj.Haxhi sqaron në mënyre analitike pr/aktin e propozuar.

Znj.Leqejza shprehet se ajo vazhdon të ngul këmbë prej vitesh që edhe në projektvendime edhe në paraqitjet e këtyre prezantimeve që ne i bëjmë para publikut, numrat të vinë pak në kontekst edhe kur na paraqitet buxheti edhe kur na paraqiten dokumente të tilla. Është esenciale për detyrimin ligjor, po ne prap mund të përshtatemi për ti dhënë qytetarit më kontekst. Duhet të kemi një krahasim me vitet e mëparshme, që të japim esencën e vizionit tonë.

Znj.Bajraktari thotë se për sa i përket fondit kontigjencë në 2026 kemi 15 milionë e 800 mijë dhe pastaj ka një zbritje me 20%, kurse 2027 dhe 2028 është rritje me 57%. Çfarë është parashikuar që kemi këtë zbritje?

Përgjigjet **Znj.Haxhi** dhe sqaron se fondi i kontigjencës është fondi që marrim nëse nuk realizohen të ardhurat. Nuk është diçka që e mbajmë. Dhe arsyeja që kjo është më e vogël është sepse tek një prej programeve është krijuar një investim ose një shpenzim, i cili ka destinacion.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve; Z.Ndou dhe Znj.Pode shprehin dakordësi, kurse Z.Bjanku shprehet se nuk mendojnë që ka informacion të mjaftueshëm, prandaj janë kundër pr/vendimit.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **29** vota Pro **8** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pr/vendimin: *Projektvendim: "Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Shkodër"*.

Relaton për pjesën e parë të këtij pr/akti **Znj.Piraniqi** dhe për pjesën tjetër **Znj.Haxhi**, drejtoreshë e përgjithshme e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj.Bajraktari kërkon të dijë se sa është vlera e të ardhura të veta të realizuara për vitin 2024?

Përgjigjet **Znj. Piraniqi**, që vlera për 2024 është 1 milion e 30 mijë e 466 lekë të reja.

Z.Galiqi thotë se praktika e paraqitjes së të ardhurave shabllon, nuk është ndonjë risi . dhe bëhet e pakuptueshme. Do ishte mirë të tregoheshin ndryshimet dhe risitë që do sjellë ky vendim, pasi shifrat nuk janë të kuptueshme për publikun e gjërë.

Z.Bjanku shprehet se a mund të na tregoni pikat e forta dhe pikat e dobëta që dalin nga ky monitorim?

Përsëri përgjigjet **Znj.Piraniqi** duke ju referuar materialit, dhe shton se një ndër pikat e forta është shtrirja e bazës së taksapaguesve dhe bashkëpunimi mes institucioneve.

Z.Pashuku merr fjalën dhe kërkon të dijë më shumë për sa i përket njësive administrative. A është menduar ndonjë zgjidhje për banorët që janë larguar dhe mbesin debitorë ndaj taksave të Bashkisë?

Znj.Piraniqi thotë se sot taksapaguesit familjarë e kanë të mundur për lidhjen e akt marrëveshjeve për tarifat ta kryejnë si nëpërmjet zyrave ashtu edhe nga agjenti tatimor i UKSH-së.

Z.Pashuku shprehet se nuk shihen ndërhyrje të kryera në Nj.administrative edhe pse është bërë vjelja e taksave.

Z.Bjanku kërkon të dijë se sa % e investimeve të veta janë realizuar?

Përgjigjet për këtë **Znj.Haxhi** duke thënë se janë realizuar së bashku me atë që janë në proces lidhje kontrate rreth 90%.

Z.Sokoli shprehet se ne duhet ti referohemi dokumentit që na është paraqitur dhe duhet të tregohemi të sinqertë , që ne kemi realizueshmëri 33% të investimeve. Nëse Bashkia do shihej në pasqyrë për punën e saj është materiali i Raportit të monitorimit.

Znj.Golemi kërkon të dijë se cila është arsyeja që shpenzimet operative janë kaq të ulta?

Përgjigjet **Znj.Haxhi** duke u përgjigjur në bazë të marterialit dhe analizes së detajuar të tij.

Z.Bjanku thotë se ky është një material me shumë rëndësi dhe kërkon vëmendje. Prandaj dhe rregullorja parashikon max 10 pika në rendin e ditës sepse po humbet përqëndrimi dhe interesi.

Hidhet në votim Pr/vendimi ,ku rezultojnë **26** vota Pro **7** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet në pikën tjetër të rendit: “ *Për miratimin e memorandumit të bashkëpunimit mbështetje për zhvillim 2023-2024 projekti “Bashki të forta”- Bashkia Shkodër*”

Relacioni është i qartë dhe propozohet të hidhet në votim.

Hidhet në votim Pr/vendimi ,ku rezultojnë **35** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet në pikën e fundit: *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Znj.Pode kërkon informacion lidhur me rrugën “Marin Bicikemi”, ku po kryhen punime të fasdave, ku në afërsi nuk janë përfshira dy pallate në gjendje të amortizuara dhe që paraqesin rrezikshmëri për banorët e zonës. A është parashikuar ndonjë projekt për rehabilitimin e tyre?

Përgjigjet **Z.Preka** duke thënë se punohet dhe jemi vetëm në fazën e parë të rikonstruksionit të fasadave. Do vlerësohen dhe do ndërhyhet në pallate të tjera patjetër në fazën e dytë të projektit.

Z.Behri në lidhje me mbarëvajtjen e sezonit turistik kërkon nga ana e Bashkisë të pastrohet sheshi kryesor në Velipojë. Po ashtu ai shton se kjo është imazh i keq për Velipojën. Ai thotë se as banjot publike nuk janë vendosur. Për më tepër kërkon të dijë kur do fillojnë punimet për rrugën që është miratuar në buxhet.

Sqaron këtu **Z.Luli** duke thënë se ju e dini që për arsye të Zgjedheje nuk lejohet tenderimi.

Z.Salihi përgjigjet se përse i përket Pastrimit, aty punohet jashtë cdo kapaciteti prej më shumë se një muaji. Dhe bari në sheshin kryesor është i krasitur dhe mund të vërtetohet lehtësisht.

Z.Pashuku shprehet se ka bërë një kërkesë para dy vitesh në lidhje me ndricimin e rrugës në kryqezimin e fshatit Bërdicë e mesme dhe fshatin Beltojë. Ai kërkon që Bashkia të ndërhyjë tek Autoriteti rrugor për këtë. Të pakten të planifikohet për vitin e ardhshëm. Ai po ashtu ngreh shqetësimin për pastrimin e kanaleve në fshatin Mali Hebaj, si dhe riparimin e rrugës aty ku ka

gropa.

Z.Salihi përgjigjet se përsa i përket ndricimit Bashkia i ka kërkuar shkresërisht Arrsh-së ndërhyrje, por sigurisht do ja rikërkojmë një gjë të tillë përsëri. Kurse ndërhyrjet në kanalet kulluese janë kryer, megjithatë do verifikohen përsëri.

Kurse **Z.Bjanku** sjell shqetësimin e ndaljes së punimeve në rrugën e Shirokës, aq më tepër në peridhen e verës dhe për turizmin.

Përgjigjet **Z.Preka**, se përsa i përket rrugës së Shirokës, punimet kanë rifilluar që dje por është kërkuar një rishikim i një detaji teknik. Ju siguroj se me ritme shumë të shpejt do arrihet edhe përfundimi i saj.

Z.Sokoli përsëri kërkon të dijë më tepër në lidhje me pjesën e rrugës nga Bahçalleku deri tek Harku i Bërdicës, a është depozituar tek ju një leje punimesh?

Përgjigjet **Z.Preka**, duke thënë se rasti është ndjekur nga ARRSH dhe i është kërkuar nga ana jonë i gjithë dokumentacioni përkatës.

Z.Sokoli përsëri kërkon të ketë më shumë informacion për banorët e asaj zone. Ai kërkon që leja e punimeve e këtij projekti duhet të zbardhet në Bashki dhe të bëhet transparente.

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka.

*Kryetari e Këshillit **Z.Luli** e deklaron mbledhjen të mbyllur.*

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 29.05.2025. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 16 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

V.o: Ky procesverbal do miratohet nga anëtarët e Këshillit në mbledhjen e rradhës së Këshillit bashkiak.

Sekretar

Sabina DANAJ

KRYETAR

Oltion LULI



Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti